



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

KRYETARI

Nr. 5429 Prot

Lushnje, me 29/06 2023

RELACION

KESHILLIT BASHKIAK

KËTU

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 117 datë 21/12/2022 PËR
SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE. ADMINISTRIMIN E TYRE NË
BASHKINË E LUSHNJËS DHE PENALITETET PËR KUNDËRVAJTJET
ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2023”**

Të nderuar zoterinj keshilltarë!

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshimet përkatëse, po ju prezantoj një ndryshim dhe shtesë në nivelin e taksave, tarifave dhe kundravajtjet administrative për vitin 2023 të Bashkisë Lushnje.

Unë në cilësinë e Kryetares të Bashkisë së Lushnjës, së bashku me strukturat administrative të Bashkisë, kemi përgatitur propozimin për ndryshim dhe shtesë në sistemin e taksave, tarifave dhe kundravajtjet administrative që do të zbatojë Bashkia jonë për vitin 2023, nisur nga kërkesa e tregtareve të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në Markaten në lagjen Xhevdet Nepravishta, si dhe nisur nga krijimin e politikave lehtësuese fiskale në Bashkinë Lushnje për të krijuar një klimë të favorshme për të gjithë qytetaret të cilët duan të ushtrojnë aktivitetin e tyre pranë kësaj markate si dhe duke qënë se Tregu i gjësë së gjalle në Njësinë Administrative Bubullim është në fazën e fundit të investimit, duke bërë të mundur vendosjen në funksion të plotë të tij kemi propozuar disa tarifa të cilat do të shërbejnë për mirembajtjen dhe funksionimin e këtij tregu.

TARIFAT E TREGUT:

Baza dhe niveli i tarifës



- TARIFA E MARKATËS

Pagesa e Tarifave të Markatës në Lagjën Xhevdet Nepravishta do të jenë mujore dhe do të paguhet në të gjitha Bankat e nivelit të dytë ose në Posta Shqiptare brenda datës 5 të cdo muaji. Tarifave të Markatës do ti nënshtrohen të gjithë ata tregtarë që ushtrojnë aktivitetin në vëndet e përcaktuara brenda Markatës. Drejtoria e të Ardhurave Vendore e Bashkisë brenda muajit Janar lidh kontrata me të gjithë tregtarët e Markatës. Të ardhurat e krijuara nga këto tarifa i takojnë 100 % Bashkisë.

- TARIFA PËR FUNKSIONIMIN E TREGUT TË GJËSË SË GJALLË BUBULLIMË

Ky treg zhvillohet pranë tregut të përqëndruar në njësinë Administrative Bubullimë, Fshati Bubullimë dhe pagesa do të kryhet sipas së tabelës së mëposhtme. Pagesa e tarifës për funksionimin e tregut të gjësë së gjallë Bubullimë do të behet brenda me pagesë të menjehershme, pranë inspektoreve të Njesisë Administrative Bubullimë ose Drejtorisë të Ardhurave Vendore.

Ishte:

Nr	Emërtimi		Njësia	Niveli Tarifës
A	1.MARKATA (Lagjja Xhevdet Nepravishta)			
1	Fruta Perime	Tarifë Pastrimi	Leke/muaj/tregtar	2,000
		Tarifë për zënien e hapësirës publike	Leke/muaj/tregtar	3,000
2	Bulmetore	Tarifë Pastrimi	Leke/muaj/tregtar	2,000
		Tarifë për zënien e hapësirës publike	Leke/muaj/tregtar	3,000

Bëhet:

Nr	Emërtimi		Njësia	Niveli Tarifës
A	1.MARKATA (Lagjja Xhevdet Nepravishta)			
1	Fruta Perime	Tarifë Pastrimi	Leke/muaj/tregtar	1,500
		Tarifë për zënien e hapësirës publike	Leke/muaj/tregtar	2,000
2	Bulmetore	Tarifë Pastrimi	Leke/muaj/tregtar	1,500
		Tarifë për zënien e hapësirës publike	Leke/muaj/tregtar	2,000



F	5.TARIFA PËR FUNKSIONIMIN E TREGUT TË GJËSË SË GJALLË BUBULLIMË		
	-Tarifa ditore-		
1	Tregtim shpendësh	leke/copë	50
2	Tregtim kafshë të imta	leke/copë	100
3	Tregtim gjedhësh	leke/copë	200
4	Tarifë parkimi për mjetet		
	Autovetura	lekë/mjet	100
	Furgona	lekë/mjet	200
	Kamiona	lekë/mjet	300

Shenim: Kjo tarifë do të vilet sipas akt-marreveshjes së nënshkruar midis paleve

Ju propozojm miratimin e taksave dhe tarifave të propozuara më sipër.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

Donald Nushi